

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim  
(zgjidhjet)**

**P6**

Data 30/01/2021

## Detyra 1

(a) Përkufizoni rrezikun e auditimit dhe përbërësit e rrezikut të auditimit. (4 pikë)

Ju jeni senior i auditimit të Audit-A dhe po planifikoni auditimin e MeBa ShA, një kompani e listuar, për vitin që përfundon më 31 Mars 2020. Kompania prodhon komponentë të kompjuterëve dhe parashikimi i fitimit para tatimit është € 33.6 milion dhe pasuritë totale janë € 79.3 milion. MeBa ShA shpërndan produktet e saj përmes shitësve me shumicë, si dhe përmes faqes së saj të internetit. Uebfaqja u azhurnua gjatë vitit me një kosto prej € 1.1 milion.

Për më tepër, kompani hyri në një transaksion në shkurt për të blerë një depo të re e cila do të kushtojë € 3.2 milion. Këshilltarët ligjorë të MeBa ShPK po punojnë për të siguruar që procesi ligjor do të përfundojë deri në fund të vitit. Kompania emetoi € 5 milion aksione preferenciale të pandryshueshme për të financuar blerjen e depos.

Gjatë vitit, drejtori i financave ka rritur jetën e dobishme ekonomike të pajisjeve nga tre në katër vjet pasi mendoi se ishte një periudhë më e përshtatshme.

Drejtori i financave informoi partnerin e angazhimit se kishin rënë dakord me një nga klientët saj me shumicë për t'ia zgatur afatin e pagesës, pasi ata kishin pasur vështirësi me ripagimin e borxhit prej €1.2 milion ndaj MeBa ShPK.

Në janar 2020, MeBa ShPK prezantoi një bonus të ri bazuar në caqet (targetat) e shitjeve për stafin e saj të shitjeve. Kjo ka rezultuar në hapjen e një numri të konsiderueshëm të llogarive të reja të klientëve me shumicë nga stafi i shitjeve. Klientëve të rinj u janë dhënë kushte të favorshme kredie si një ofertë hyrëse, me kusht që mallrat të blihen brenda një periudhe dy-mujore. Si rezultat, të ardhurat janë rritur me 5% krahasuar me vitin paraprak.

Kompania ka lansuar disa produkte të reja këtë vit dhe të gjitha, përveç njëjës, kanë qenë të suksesshme. Reagimi për produktin Luge, i lansuar katër muaj më parë, ka qenë i përzier dhe kompania sapo ka marrë njoftim nga një prej klientëve të tyre, Peta Co, për veprimet ligjore të synuara. Ata po pretendojnë se produkti kishte të meta, duke rezultuar në një humbje të konsiderueshme të informacionit dhe një ndikim të dëmshëm të vazhdueshëm në fitime. Si një masë paraprake, shitjet e produktit Luge janë ndaluar dhe është inicuar tërheqja e produktit nga tregu për çdo produkt të Luge të shitur në katër muajt e fundit.

Drejtori i financave është i prirur të shpallë rezultatet financiare të kompanisë në tregun e aksioneve më herët se vitin e kaluar dhe për ta lehtësuar këtë, ai ka pyetur nëse auditimi mund të përfundojë në një afat më të shkurtër. Për më tepër, kompania synon të propozojë një dividend përfundimtare sapo të finalizohen pasqyrat financiare.

Drejtori i financave të MeBa ShPK ka informuar partnerin e angazhimit të auditimit se një nga drejtorët jo-ekzekutivë të kompanisë (DJE) sapo ka dhënë dorëheqjen dhe ai ka pyetur nëse partnerët në Audit-A mund të ndihmojnë MeBa ShPK në rekrutimin e një DJE të ri. Konkretisht ai ka kërkuar rishikuesin e kontrollit të cilësisë së angazhimit, i cili ishte deri vitin e kaluar partneri i angazhimit të auditimit në MeBa ShPK, të ndihmojë kompaninë në këtë rekrutim.

Audit-A gjithashtu ofron shërbime tatimore për MeBa ShPK në formën e përgatitjes së deklaratave tatimore së bashku me disa këshilla për planifikimin e tatimeve. Drejtori i financave i ka rekomanduar komitetit të auditimit të MeBa ShPK që tarifa e auditimit të këtij viti duhet të bazohet në fitimin e kompanisë para tatimit. Në datën e sotme, 20% e tarifës së auditimit të vitit të kaluar është ende e papaguar dhe duhej të paguhej tre muaj më parë.

**Kërkohet:**

(b) Përshkruani TETË rreziqe të auditimit dhe shpjegoni përgjigjen e auditorit ndaj secilit rrezik, në planifikimin e auditimit të MeBa ShPK. Shënim: Përgatitni përgjigjen tuaj duke përdorur përkatësisht dy kolona të titulluara *Rreziku i auditimit* dhe *Përgjigja e auditorit*. **(16 pikë)**

(c) (i) Identifikoni dhe shpjegoni PESË kërcënime etike që mund të ndikojnë në pavarësinë e auditorit të MeBa ShPK; dhe

(ii) Për secilin kërcënim, sugjeroni një masë mbrojtëse për të zvogëluar rrezikun në një nivel të pranueshëm. Shënim: pikët totale do të ndahen në mënyrë të barabartë midis secilës pjesë. Përgatitni përgjigjen tuaj përkatësisht duke përdorur dy kolona me titull *Kërcënimi etik* dhe *Masa mbrojtëse*. **(10 pikë)**

**[Total: 30 pikë]**

## Zgjidhja

### (a) Rreziku i auditimit dhe përbërësit e rrezikut

Rreziku i auditimit është rreziku që auditori shpreh një opinion të papërshtatshëm të auditimit kur pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale. Rreziku i auditimit është një funksion i dy përbërësve kryesorë, rreziku i anomalirë materiale dhe rreziku i moszbulimit. Rreziku i anomalisë materiale përbëhet nga dy komponentë të tjerë, rreziku i vetëvetishëm dhe rreziku i kontrollit. Rreziku i vetëvetishëm është ndjeshmëria e një pohimi në lidhje me një klasë të transaksioneve, bilancit të llogarisë ose shpalosje ndaj anomalisë e cila mund të jetë materiale, qoftë individualisht ose kur bashkohet me anomalitë tjera, para se të merret në konsideratë ndonjë kontroll përkatës. Rreziku i kontrollit është rreziku një anomal që mund të ndodhë në një pohim në lidhje me një klasë të transaksioneve, bilancit të llogarisë ose shpalosje dhe që mund të jetë material, qoftë individualisht ose kur bashkohet me anomalitë tjera, nuk do të parandalohet, ose zbulohet dhe korrigjohet, me kohë nga kontrolli i brendshëm i entitetit. Rreziku i moszbulimit është rreziku që procedurat e kryera nga auditori për të ulur rrezikun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm nuk do të zbulojnë një anomal që ekziston dhe që mund të jetë materiale, qoftë individualisht ose kur bashkohet me anomalitë tjera. Rreziku i moszbulimit ndikohet nga rreziku i mostrimit dhe jomostimit.

### (b) Rreziku i auditimit dhe përgjigja e auditorit

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditorit
MeBa ShPK e azhurnoi uebfaqen e tyre gjatë vitit me një kosto prej 1.1 milion €. Kostot e bëra duhet të alokohen në mënyrë të saktë ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve kapitale. Ndërsa uebfaqja është azhurnuar, ekziston mundësia që proceset dhe sistemet e reja të mos regjistrojnë të dhëna në mënyrë të besueshme dhe të saktë. Kjo mund të çojë në një rrezik mbi plotësinë dhe saktësinë e të dhënave në regjistrat themelore të kontabilitetit	Rishikoni ndarjen e kostove dhe përputhni me faturat për të vlerësuar natyrën e shpenzimeve dhe nëse është shpenzim kapital, përputhni me regjistrin e pasurive ose përputhni me pasqyrën e të ardhurave. Ekipi i auditimit duhet të dokumentojë sistemin e rishikuar dhe të ndërmarrë teste mbi plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të regjistruara nga faqja e internetit në regjistrat e kontabilitetit.
MeBa ShPK ka hyrë në një transaksion për të blerë një depo të re për 3.2 milion € dhe parashikohet që procesi ligjor të përfundojë deri në fund të vitit. Vetëm pasuritë që ekzistojnë fizikisht në fund të vitit duhet të përfshihen në pasuritë joqarkulluese. Nëse transaksioni nuk ka përfunduar deri në fund të vitit, ekziston rreziku që pasuritë të mbivlerësohen nëse kompania përfshin gabimisht depon në fund të vitit.	Diskutoni me menaxhmentin nëse blerja e depon ka përfunduar deri në fund të vitit. Nëse është kështu, inspektoni dokumentet ligjore të pronësisë, siç janë aktet e pronësisë që sigurojnë që këto të datohen para shkurtit dhe janë në emrin e kompanisë.
Një financim i konsiderueshëm është marrë në vit, pasi kompania ka emetuar 5 milion € të aksioneve preferenciale të pakthyeshme. Ky financim duhet të trajtohet në mënyrë të saktë, duke bërë shpalosjen e duhur. Meqenëse aksionet preferenciale janë të pakthyeshme, ato duhet të klasifikohen si ekuitet më shumë sesa detyrime joqarkulluese. Mosklasifikimi i saktë i	Rishikoni dokumentacionin e emetimit të aksioneve për të konfirmuar që aksionet e preferenciale janë të pakthyeshme. Konfirmoni që ato janë klasifikuar saktë si kuitet në regjistrat e kontabilitetit dhe se të ardhurat totale të financimit prej 5 milion € janë marrë. Për më tepër, shpalosjet për këtë çështje të aksioneve duhet të rishikohen në

<p>aksioneve mund të rezultojë në ekuitet të nënvlerësuar dhe detyrime joqarkulluese të mbivlerësuar.</p>	<p>detaje për të siguruar pajtueshmërinë me standardet përkatëse të kontabilitetit.</p>
<p>Drejtori financiar ka zgjatur jetën e dobishme të pajisjeve nga tre në katër vjet, duke rezultuar në uljen e shpenzimit të zhvlerësimit. Sipas SNK 16, jeta e dobishme duhet të rishikohet çdo vit, dhe nëse jetëgjatësia e pasurisë është rritur vërtet, atëherë ky ndryshim është i arsyeshëm. Megjithatë, ekziston rreziku që kjo zgjatje të ketë ndodhur në mënyrë që të rritet fitimet. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë pajisjet mbivlerësohen dhe fitimi mbivlerësohet.</p>	<p>Diskutoni me drejtorët arsyetimin për çdo zgjatje të jetës së pasurive dhe uljen e normave të zhvlerësimit. Gjithashtu, jeta katër-vjeçare duhet të krahasohet me sa shpesh zëvendësohen këto pasuri, për të vlerësuar jetën e dobishme të pasurive.</p>
<p>Një klient i MeBa ShPK ka hasur vështirësi në pagimin e borxhit të tyre të papaguar prej € 1.2 milion dhe MeBa ShPK ka rënë dakord për një zgjatje të afatit të pagesës. Nëse klienti është duke pasur vështirësi, ekziston një rrezik i shtuar që të arkëtueshmet të mos rikuperohen dhe prandaj të mbivlerësohen.</p>	<p>Rishikoni kushtet e rishikuara të afatit të pagesës dhe identifikoni nëse pas datës janë bërë pranime parash për këtë klient. Diskutoni me drejtorin financiar nëse ai synon të njuh një provision për këtë të arkëtueshme. Nëse jo, rishikoni nëse ndonjë provision ekzistues për llogaritë e pambledhshme është i mjaftueshëm për të mbuluar shumën e kësaj të arkëtueshme</p>
<p>Një skemë bonusesh e lidhur me shitjet është aprovuar gjatë vitit për stafin e shitjeve, që ka rritur një numër të konsiderueshëm të llogarive të reja të klientëve me kushte të favorshme kredie që janë hapur para fundit të vitit. Kjo ka rezultuar në një rritje prej 5% të të hyrave. Stafi i shitjeve që kërkon të maksimizojë bonusin e tyre aktual mund të rezultojë në hapjen e llogarive të reja në mënyrë të pakujdesshme për klient që mund të mos kenë aftësinë e pagesës dhe në këtë mënyrë të çojnë në të arkëtueshme të pakthyeshme. Përveç kësaj, ekziston rreziku i gabimeve të prerjes së shitjeve pasi klientët e rinj mund të bëjnë porosi brenda periudhës hyrëse dy mujore dhe më pas t'i kthejnë këto mallra pas fundit të vitit.</p>	<p>Duhet të kryhet testim më i madh i prerjes së shitjeve së bashku me një rishikim të çdo kthimi pas fundit të vitit pasi ato mund të tregojnë gabime të prerjes. Për më tepër, duhet të kryhet testim i pranimeve të parave të gatshme pas datës për llogaritë e reja të arkëtueshme</p>
<p>MeBa ShPK ka ndaluar shitjet e mëtejshme të produktit të saj të ri Luge dhe ka filluar një tërheqje e produkteve për çdo mall të shitur në katër muajt e fundit. Nëse ka probleme me cilësinë e produktit Luge, stoqet mund të mbivlerësohen pasi VNR e tyre mund të jetë nën kosto. Për më tepër, produktet e Luge të shitura brenda katër muajve të fundit janë duke u tërhequr, kjo do të rezultojë që MeBa ShPK të rimbursoj klientët. Shitja do të duhet të hiqet; një detyrim i rimbursimit duhet të njihet së bashku me ridekalimin e stoqeve, edhe pse VNR e këtyre stoqeve mund të ketë</p>	<p>Diskutoni me drejtorin financiar nëse do të bëhen shlyerje të këtij produkti dhe cilat modifikime mund të kërkohen në lidhje me cilësinë. Duhet të kryhen teste për të konfirmuar koston dhe VNR të produkteve Luge në stoqe dhe nëse mallrat vlerësohen saktë linjë pas linjës. Rishikoni listën e shitjeve të bëra të produktit Luge para tërheqjes, pajtohuni që shitja është hequr nga të hyrat dhe përfshihet në stoqe. Nëse rimbursimi nuk është paguar para fundit të vitit, bini dakord që përfshihet në detyrimet qarkulluese.</p>

<p>një vlerë minimale. Mos llogaritja e duhur e kësaj mund të rezultojë në të hyra të mbivlerësuara dhe detyrime dhe stoqe të nënvlerësuara.</p>	
<p>Peta Co, një klient i MeBa ShPK, ka njoftuar se synojnë të fillojnë veprimet ligjore për humbjen e informacionit dhe fitimeve si rezultat i produktit Luge. Nëse është e mundshme që kompania do të bëjë pagesa ndaj klientit, kërkohet një provizion ligjor. Nëse pagesa ka pak gjasa të ndodhë, atëherë duhet të shpaloset një detyrim kontingjent. Nëse MeBa ShPK nuk e ka bërë këtë, ekziston rreziku mbi plotësinë e provizioneve ose shpalosjen e nevojshme të detyrimeve kontingjente.</p>	<p>Audit-A duhet t'u shkruajë avokatëve të kompanisë për të pyetur lidhur me ekzistencën dhe gjasat e suksesit të çdo pretendimi nga Peta Co. Rezultatet e kësaj duhet të përdoren për të vlerësuar nivelin e provizionit ose shpalosjes së përfshirë në pasqyrat financiare.</p>
<p>Drejtori i financave ka kërkuar që auditimi të përfundojë një javë më herët se normalisht pasi ai dëshiron të raportojë rezultatet më herët. Një zvogëlim në orarin e auditimit do të rrisë rrezikun e moszbulimit dhe do të ushtrojë presion shtesë mbi ekipin në marrjen e dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Për më tepër, ekipi i financave i MeBa ShPK do të ketë më pak kohë për të përgatitur informacionin financiar duke çuar në një rrezik në rritje të anomalive që mund të paraqiten në pasqyrat financiare.</p>	<p>Orari duhet të konfirmohet me drejtorin e financave. Nëse do të zvogëlohet, atëherë duhet të merret parasysh kryerja e një auditimi të ndërmjetëm në fund të marsit ose në fillim të prillit; kjo pastaj do të ulte presionin mbi auditimin përfundimtar. Ekipi duhet të mbajë skepticizëm profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rritjes së rrezikut të ndodhjes së gabimeve.</p>
<p>Kompania synon të propozojë një dividend përfundimtare pasi të jenë përfunduar pasqyrat financiare. Kjo shumë nuk duhet të parashikohet në pasqyrat financiare të vitit, pasi detyrimi lind vetëm pasi të shpallet dividendi, e që është fundi i vitit. Në përputhje me SNK 10 Ngjarjet pas datës së raportimit, dividendi duhet të shpaloset. Nëse dividendi përfshihet, kjo do të rezultojë në një mbivlerësim të detyrimeve dhe nënvlerësimin e ekuitetit.</p>	<p>Diskutoni çështjen me menaxhmentin dhe konfirmoni që dividendi nuk do të përfshihet në detyrimet në pasqyrat financiare të vitit. Pasqyrat financiare duhet të rishikohen për të siguruar përfshirjen e shpalosjeve adekuate të dividendit të propozuar.</p>

(c) Kërcënimet etike dhe masat mbrojtëse

<b>Kërcënimet etike</b>	<b>Masat mbrojtëse</b>
<p>Drejtori i financave dëshiron të raportojë rezultatet financiare të MeBa ShPK më herët sesa normalisht dhe ka pyetur nëse auditimi mund të përfundojë në një hark kohor më të shkurtër. Kjo mund të krijojë një kërcënim të frikësimit për ekipin pasi ata mund të ndjehen nën presion për të kryer punën shkel-e-shko dhe për të mos ngritur çështje në mënyrë që të përmbushin afatet dhe kjo</p>	<p>Partneri i angazhimit duhet të diskutojë kohën e auditimit me drejtorin e financave për të kuptuar nëse auditimi mund të fillojë më herët, në mënyrë që të sigurojë kohën e duhur për ekipin për të mbledhur dëshmi. Nëse kjo nuk është e mundur, partneri duhet të informojë me mirësjellje drejtorin e financave që ekipi do të ndërmarrë auditimin në përputhje me të gjitha SNA-të përkatëse</p>

<p>mund të kompromentojë objektivitetin e ekipit të auditimit dhe cilësinë e auditimit të kryer.</p>	<p>dhe procedurat e kontrollit të cilësisë. Prandaj, auditimi nuk ka gjasa të përfundojë më herët. Nëse mbetet ndonjë shqetësim ose vazhdon kërcënimi i frikësimit, atëherë Audit-A mund të konsiderojë dorëheqjen nga angazhimi.</p>
<p>Një drejtor jo-ekzekutiv (DJE) i MeBa ShPK sapo ka dhënë dorëheqjen dhe drejtorët kanë pyetur nëse partnerët e Audit-A mund t'i ndihmojnë ata në rekrutimin për të plotësuar këtë vend të lirë pune. Kjo përfaqëson një kërcënim të interesit personal pasi firma e auditimit nuk mund të ndër marrë rekrutimin e anëtarëve të bordit të MeBa ShPK, veçanërisht një DJE i cili do të ketë një rol kryesor në mbikëqyrjen e procesit të auditimit dhe firmës së auditimit</p>	<p>Audit-A është në gjendje të ndihmojë MeBa ShPK në atë mënyrë që ata mund të marrin role të tilla si rishikimi i një liste të shkurtër të kandidatëve dhe rishikimi i kualifikimeve dhe përshtatshmërisë. Sidoqoftë, firma duhet të sigurojë që ata nuk po marrin vendime menaxheriale dhe kështu që nuk duhet të kërkojë kandidatë për pozicionin ose të marrë vendimin përfundimtar se kush duhet emëruar.</p>
<p>Rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit (EQCR) i caktuar për MeBa ShPK ishte deri vitin e kaluar partneri i angazhimit të auditimit. Kjo paraqet një kërcënim familjariteti pasi partneri do të ketë qenë i lidhur me MeBa ShPK për një periudhë të gjatë kohore dhe kështu mund të mos mbajë skepticizmin profesional dhe objektivitetin.</p>	<p>Meqë MeBa ShPK është një kompani e listuar, atëherë partneri i mëparshëm i angazhimit të auditimit nuk duhet të përfshihet në auditim për të paktën një periudhë prej dy vjetësh. Në vend të kësaj duhet të caktohet një rishikues alternativ.</p>
<p>Audit-A ofron shërbime të tatimit, angazhimin e auditimit dhe ndoshta shërbime në lidhje me rekrutimin e DJE. Ekziston një kërcënim i mundshëm i interesit vetjak ose frikësimit pasi tarifat totale mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të të hyrave të Audit-A dhe firma mund të bëhet tepër e varur nga MeBa ShPK, duke rezultuar në firmën më pak sfiduese ose objektive për shkak të frikës së humbjes së një klienti i rëndësishëm.</p>	<p>Audit-A duhet të vlerësojë nëse tarifat e auditimit, rekrutimit dhe tatimit do të përfaqësonin më shumë se 15% të të ardhurave bruto të firmës për dy vjet rresht. Nëse tarifat e përsëritura ka gjasë të tejkalojnë 15% të të hyrave vjetore të firmës këtë vit, duhet të merret në konsideratë shtesë nëse shërbimet e rekrutimit dhe tatimit duhet të ndërmerren nga firma. Për më tepër, nëse tarifat tejkalojnë 15%, atëherë kjo duhet t'u shpalojë personave të ngarkuar me qeverisjen në MeBa ShPK. Nëse firma mban të gjithë punën, ajo duhet të bëjë një rishikim të angazhimit para se të lëshohet opinioni i auditimit pasi të jetë lëshuar opinioni nga një auditor i jashtëm ose nga një organ rregullator.</p>
<p>Drejtori i financave ka sugjeruar që tarifa e auditimit të bazohet në fitimin para tatimit të MeBa ShPK që përbën një tarifë kontingjente. Tarifat e kontingjente krijojnë një kërcënim të interesit vetjak dhe janë të ndaluara sipas Kodit të Etikës së IFAC. Nëse tarifa e auditimit bazohet në fitim, ekipi mund të jetë i prirur të injorojë korrigjimet e kërkuara të auditimit që mund të çojnë në një ulje të fitimit</p>	<p>Audit-A nuk do të jetë në gjendje të pranojë tarifa kontingjente dhe duhet t'u personave të ngarkuar me qeverisjen në MeBa ShPK se Tarifa e auditimit të jashtëm duhet të bazohet në kohën e kaluar dhe nivelet e aftësive dhe përvojës së anëtarëve të kërkuar të ekipit të auditimit.</p>

<p>Në datën e sotme, 20% e tarifës së auditimit të vitit të kaluar është ende e papaguar dhe kishte afatin për t'u paguar tre muaj më parë. Një kërcënim i interesit vetjak mund të paraqitet nëse tarifat mbeten të papaguara, pasi Audit-A mund të ndiejë presion për të rënë dakord për korrigjime të caktuara të kontabilitetit në mënyrë që të paguhet viti paraprak dhe tarifa e këtij viti e auditimit. Përveç kësaj, tarifat e papaguara mund të perceptohen si një hua për një klient e që është rreptësisht i ndaluar.</p>	<p>Audit-A duhet të diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen arsyet pse 20% e tarifës së vitit të kaluar nuk është paguar. Ata duhet të bien dakord për një orar të rishikuar të pagesave që do të rezultojë në vendosjen e tarifave para se të kryhet më shumë punë për auditimin e vitit aktual.</p>
--	--



## Detyra 2

Ju jeni asistent i auditimit në auditimin e HR-Res ShPK, një kompani e cila ofron këshilla për karrierën për klientët. Kompania gjithashtu shet kostume dhe veshje për klientët e saj. Tani jeni duke përfunduar punën në terren të auditimit për vitin e mbyllur më 30 qershor 2020 dhe jeni duke kryer një numër detyrash përpara takimit përmblyllës me klientin. Gjatë rrjedhës së auditimit, u identifikuan një numër çështjesh potenciale të auditimit, të cilat janë detajuar në pikat 1 deri 3 më poshtë. Menaxheri i auditimit ka kërkuar që ju të përgatishni një përmbledhje të çështjeve të auditimit dhe implikimet e tyre të cilat mund të përdoren nga partneri i auditimit për diskutim në takimin përmblyllës. HR-Res ShPK ka bërë fitime të qëndrueshme në vitet e fundit. Fitimi para tatimit për HR-Res ShPK për vitin e mbyllur më 31 Mars 2020 ishte €4,000,000.

1. HR-Res ShPK ka një provision të garancisë në draft Pasqyrën e saj të Pozicionit Financiar në 31 Mars 2020 prej €180,000. Derisa është audituar kjo saldo, ekipi juaj i auditimit kërkoi një përfaqësim me shkrim nga menaxhmenti i HR-Res ShPK, për të konfirmuar që baza dhe shuma e provizionit janë të arsyeshme. Menaxhmenti ka refuzuar të sigurojë përfaqësimin e kërkuar me shkrim.

2. Gjatë auditimit, ju erdhi në vëmendjen tuaj që një saldo e arkëtueshme prej €310,000 ka gjasë të jetë e paarkëtueshme. Drejtorët e HR-Res ShPK nuk kanë ndërmend të bëjnë ndonjë provizion për borxhet e këqija në lidhje me këtë saldo të arkëtueshme.

3. Si pjesë e testimit të arkëtimit me para, u vërejt se €75,000 u morën nga një klient i madh në Mars 2020 në lidhje me kurset e këshillimit të karrierës që do të zhvilloheshin midis Prillit dhe Majit 2020. Kjo shumë e plotë është regjistruar si e hyrë në pasqyrat financiare për vitin që përfundoi më 31 mars 2020.

### **Kërkohet:**

(a) Diskutoni, në kontekstin e një auditimi të pasqyrave financiare, çfarë nënkuptohet me termin 'i përhapur' dhe ndikimi i tij në raportin e auditimit. **(4 pikë)**

(b) Shpjegoni qëllimin e një paragrafi të 'theksimit të çështjes' dhe, nëse kërkohet, kur duhet të përfshihet në një raport të auditimit. **(4 pikë)**

(c) Në lidhje me tre çështjet e auditimit të përmendura më lart, rekomandoni një përfundim të auditimit për secilën nga këto çështje dhe gjithashtu tregoni ndikimin që këto çështje mund të kenë në raportin e auditimit për HR-Res ShPK në 31 Mars 2020. Ju mund të supozoni se HR-Res ShPK nuk është i gatshëm të bëjë ndonjë ndryshim në draft pasqyrat e tij financiare. **(12 pikë)**

**[Total: 20 pikë]**

## Zgjidhja

(a) Në kontekstin e një auditimi, termi "i përhapur" mund të gjendet në SNA 705 - Modifikimet e Opinionit në Raportin e Auditorit të Pavarur.

Efektet përhapëse në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- Nuk kufizohen në elemente specifike, llogari ose zëra të pasqyrave financiare
- Nëse është i kufizuar, përfaqësoni ose mund të përfaqësoj një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare
- Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e përdoruesve të pasqyrave financiare

Me fjalë të tjera, përhapëse do të thotë që gabimet ose anomalitë mund të gjenden kudo dhe janë shqetësime serioze. Nëse llogaritë janë të përhapura, kjo do të çojë në një opinion të modifikuar të auditimit. Nëse ka një kufizim të fushëveprimit në auditim i cili është material dhe i përhapur, auditorët do të lëshojnë një "mohim / refuzim të opinionit". Nëse ka një anomali materiale (mosmarrëveshje) atëherë auditorët do të lëshojnë një "opinion kundër" që pasqyrat financiare nuk japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

(b) Shpjegoni qëllimin e paragrafit "theksimi i çështjes" dhe, nëse kërkohet, kur duhet të përfshihet në një raport të auditimit. Një paragraf i "theksimit të çështjes" mund të gjendet në SNA 706 - Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe Paragrafët e Çështjeve Tjera në Raportin e Auditorit të Pavarur. Paragrafi i theksimit të çështjes është një paragraf i përfshirë në raportin e auditorit që i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare që, sipas gjykimit të auditorit, është e një rëndësie të tillë që është thelbësore për kuptimin e përdoruesve të pasqyrave financiare. Një shembull do të ishte pasiguria në lidhje me rezultatin e ardhshëm të një procesi gjyqësor që auditori e konsideron të nevojshme për të sjellë në vëmendjen e lexuesit. Do të përfshihej në një raport të pakualifikuar të auditimit të dhe vetëm nëse do të kishte pasiguri të shumta të konsiderueshme, do të rezultonte në një opinion të modifikuar të auditimit. Zakonisht ndjek paragrafin "Baza për Opinion" në raportin e auditorit dhe titullohet qartë "Theksimi i Çështjes". Paragrafi duhet të bëjë të qartë se opinionin nuk është modifikuar në lidhje me çështjen që po theksohet.

(c) Ju mund të supozoni se Gr8 Careers Limited nuk është i gatshëm të bëjë ndonjë ndryshim në draft pasqyrat e tij financiare.

1. Çështja mund të jetë materiale pasi përfaqëson 4.5% (180,000 € / 4,000,000 €) të shifrës së fitimit para tatimit të HR-Res ShPK për periudhën nën auditim. Duke pasur parasysh dëshmitë e kufizuara të disponueshme përveç përfaqësimit, auditori nuk do të jetë në gjendje të mbledhë dëshmitë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit mbi provizionin material të garancisë. Anomalia nuk ka gjasë të konsiderohet e përhapur. Prandaj, kërkohet një opinion i auditimit "përveç për", pasi anomalia e mundshme që mund të ekzistojë është materiale por jo e përhapur. Raporti i auditorit do të përfshijë një paragraf pas paragrafit të opinionit, i cili siguron një përshkrim të çështjes që shkakton modifikimin. Ky paragraf do të titullohet "Baza për opinion të kualifikuar".

2. Kjo çështje është materiale pasi përfaqëson 7.75% (310,000 € / 4,000,000 €) e shifrës totale të fitimit para tatimit të HR-Res ShPK për periudhën nën auditim. Çështja është se pasqyrat financiare nuk janë të pastra nga anomalitë materiale. Çështja nuk ka gjasë të konsiderohet të jetë e përhapur. Prandaj, do të kërkohet një opinion i kualifikuar i auditimit "përveç për". Raporti

i auditorit do të përfshijë një paragraf pas paragrafit të opinionit, i cili ofron një përshkrim të çështjes që shkakton modifikimin. Ky paragraf do të titullohet "Baza për opinion të kualifikuar".

3. Kjo çështje është jomateriale pasi përfaqëson 1.63% (65,000 € / 4,000,000 €) të shifrës totale të fitimit para tatimit të HR-Res ShPK për periudhën nën auditim. Kjo është një çështje e prerjes që të ardhurat janë njohur gabimisht në periudhën e gabuar të kontabilitetit dhe nuk duhet të përfshihen në draft pasqyrat financiare të vitit 2020. Kërkohej një korrigjim në draft pasqyrën financiare. Sidoqoftë, kjo nuk do të ndikojë në raportin e auditimit dhe nuk do të jetë i nevojshëm opinion i modifikuar.

### Detyra 3

Anda Shpk ofron shërbime shkencore për një gamë të gjerë klientësh. Detyrat tipike variojnë nga testimi i ushqimit për aditivë të paligjshëm në ofrimin e analizave mjeko-ligjore (forenzike) mbi elementet e përdorur për të kryer krime për të ndihmuar oficerët e policisë në hetime.

Auditimi vjetor është gati në përfundim. Si senior i auditimit, ju i keni raportuar partnerit të angazhimit se Anda është duke kaluar në disa vështirësi financiare. Të hyrat kanë rënë për shkak të efektit negativ të dy çështjeve gjyqësore të profilit të lartë, ku shërbimet e Anda për të ndihmuar prokurorinë kishin gabime. Jo vetëm që kjo bëri publicitet të pafavorshëm për Andën, por një numër klientësh tërhoqën kontratat e tyre. Një punonjës senior më pas u largua nga Anda, duke deklaruar se mungesa e investimeve në makineritë e reja të analizave ka rritur rrezikun e dhënies së informacionit të pasaktë nga kompania.

Një parashikim i rrjedhës së parave të gatshme i përgatitur nga Anda kërkon para shtesë të konsiderueshme brenda 12 muajve të ardhshëm për të ruajtur nivelin aktual të shërbimeve të kompanisë. Auditorëve të kompanisë u është kërkuar të japin një raport të sigurisë së kufizuar (*më herët e njohur si siguri negative*) mbi këtë parashikim.

#### **Kërkohet:**

- (a) Përkufizoni 'hipotezën e vijimësisë' dhe diskutoni mbi përgjegjësitë e auditorit në lidhje me këtë hipotezë. **(4 pikë)**
- (b) Tregoni procedurat e auditimit që mund të kryhen për të përcaktuar nëse Anda Shpk është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë apo jo. **(8 pikë)**
- (c) Shpjegoni procedurat e auditimit që auditori mund të kryej auditori nëse ka vendosur që Anda Shpk nuk ka gjasa të operoj sipas hipotezës së vijimësisë. **(4 pikë)**
- (d) Në kontekstin e parashikimit të parasë së gatshme, përshkruani termin 'siguri e kufizuar' dhe shpjegoni se si ndryshon kjo nga siguria e ofruar nga një raport auditimi mbi pasqyrat financiare. **(4 pikë)**

**[Total: 20 pikë]**

## Zgjidhja

### a) Hipoteza e vijimësisë

Hipoteza e vijimësisë do të thotë që ndërmarrja do të vazhdojë në ekzistencën operacionale për një të ardhme të parashikueshme pa qëllim ose domosdoshmërinë e likuidimit ose ndryshe ndërprerjen e operacioneve. Është një nga konceptet themelore të kontabilitetit të përdorura nga auditorët dhe e paraqitur në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare.

Përgjegjësia e auditorit në lidhje me hipotezën e vijimësisë shpjegohet në SNA 570 Hipoteza e Vijimësisë. SNA thotë 'kur planifikohen dhe kryehen procedurat e auditimit dhe në vlerësimin e rezultateve të tyre, auditori duhet të marrë parasysh përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga menaxhmenti në përgatitjen e pasqyrave financiare.'

Përgjegjësia e auditorit prandaj bie në tre fusha:

- (i) Të kryejë procedurat e duhura të auditimit që do të identifikojnë nëse një organizatë mund të vazhdojë ose jo sipas hipotezës së vijimësisë.
- (ii) Për të siguruar që menaxhmenti i organizatës ka qenë realist në përdorimin e tyre të hipotezës së vijimësisë gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.
- (iii) Për t'u raportuar anëtarëve kur ata konsiderojnë se hipoteza e vijimësisë është përdorur në mënyrë të papërshtatshme, për shembull, kur pasqyrat financiare tregojnë se organizata operon sipas hipotezës së vijimësisë, por procedurat e auditimit tregojnë se kjo mund të mos jetë kështu.

### (b) Procedurat e auditimit në lidhje me hipotezën e vijimësisë

- Merrni një kopje të parashikimit të rrjedhës së parasë dhe diskutoni rezultatet e kësaj me drejtorët.
- Diskutoni me drejtorët pikëpamjen e tyre nëse Smithson mund të operojë sipas hipotezës së vijimësisë. Kërkoni arsyet e tyre dhe provoni dhe përcaktoni nëse këto janë të sakta.
- Pyetni drejtorët nëse ata kanë marrë në konsideratë ndonjë formë tjetër të financimit për kompaninë për të kompensuar mungesën e parave të gatshme të identifikuar në parashikimin e rrjedhës së parasë.
- Merrni një kopje të çdo pasqyre financiare të ndërmjetme të kompanisë për të përcaktuar nivelin e shitjeve / të ardhurave pas fundit të vitit dhe nëse kjo përputhet me parashikimin e rrjedhës së parasë.
- Pyesni për mungesën e mundshme të investimeve kapitale brenda kompanisë të identifikuar nga punonjësi që u largua. Rishikoni nivelet aktuale të pasurive joqarkulluesse me kompani të ngjashme dhe rishikoni politikën e blerjes me drejtorët.
- Merrni parasysh shkallën në të cilën kompania u mbështet tek punonjësi senior i cili kohët e fundit u largua nga kompania. Pyesni departamentin e burimeve njerëzore nëse punonjësi do të zëvendësohet dhe nëse po sa shpejt.
- Merrni një letrën nga avokati dhe rishikoni për të identifikuar çdo pretendim ligjor kundër kompanisë në lidhje me shërbimet nën-standard që u ofrohen klientëve. Kur është e mundur, merrni parasysh ndikimin financiar në kompani dhe nëse është i disponueshëm sigurimi për të zbutur ndonjë pretendim.
- Rishikoni librin e porosive kompanisë dhe listat e klientëve për të provuar dhe përcaktuar vlerën e porosive të ardhshme krahasuar me vitet e mëparshme.
- Rishikoni konfirmimin bankar për të përcaktuar shkallën e çdo kredie bankare dhe nëse ripagimet e në 12 muajt e ardhshëm mund të bëhen pa huazime të mëtejshme.
- Rishikoni ngjarje të tjera pas përfundimit të vitit financiar dhe përcaktoni nëse këto kanë ndikim në kompani.
- Merrni një pikë letre përfaqësimi për të konfirmuar mendimin e drejtorëve se kompania operon sipas hipotezës së vijimësisë (HV).

### (c) Procedurat e auditimit nëse kompania konsiderohet se nuk operon sipas HV

- Diskutoni përsëri situatën me drejtorët. Merrni parasysh nëse kërkohen shpalosje shtesë në pasqyrat financiare ose nëse pasqyrat financiare duhet të përgatiten mbi bazën e 'likuidimit'.

- Shpjegojuni drejtorëve se nëse nuk bëhet shpalosja shtesë ose rdeklarimi i pasqyrave financiare, atëherë auditori do të duhet të modifikojë raportin e auditimit.
- Konsideroni se si duhet të modifikohet raporti i auditimit. Aty ku drejtorët japin shpalosje adekuate të situatës me HV, atëherë ka të gjasë të jetë i përshtatshëm paragrafi i “pasigurisë materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë” (Shënim: më herët është ëprdorur paragrafi i theksimit të çështjes) për të tërhequr vëmendjen ndaj shpalosjes së hipotezës së vijimësisë.
- Në rast se drejtorët nuk bëjnë shpalosje adekuate të HV, atëherë kualifikoni raportin e auditimit duke iu referuar problemit të HV. Kualifikimi do të jetë një opinion me ‘përveç për’ ose një opinion i kundërt në varësi të opinionit të auditorit për situatën.

#### (d) Siguria e kufizuar

Siguria e kufizuar (më herët e njohur si siguri ‘negative’) do të thotë se asgjë nuk ia ka tërhequr vëmendjen e një auditori që tregon se parashikimi i rrjedhës së parasë përmban ndonjë anomali materiale. Prandaj siguria jepet për mungesën e ndonjë treguesi për të kundërtën.

Në të kundërt, raporti i auditimit mbi pasqyrat financiare statutore ofron një siguri pozitive ose të arsyeshme; kjo do të thotë që pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Duke përdorur sigurinë e kufizuar, auditori paralajmëron përdoruesit se parashikimi i rrjedhës së parasë mund të jetë i pasaktë. Prandaj, përdoruesit mund të mbështeteten më pak në ata parashikim sesa në pasqyrat financiare, ku është dhënë siguria pozitive.

Me siguri të kufizuar, auditori paralajmëron gjithashtu se kishte procedura të kufizuara të auditimit që mund të përdoren; rrjedha e parasë ka të bëjë me të ardhmen dhe për këtë arsye auditori nuk mund të marrë të gjitha dëshnimtë për të garantuar saktësinë e tyre. Pasqyrat financiare kanë të bëjnë me të kaluarën, dhe kështu auditori duhet të jetë në gjendje të marrë informacionin për të konfirmuar se janë të sakta; pra përdorimi i sigurisë pozitive.

#### Detyra 4

(a) Krahasoni dhe bëni dallimin në mes të rolit të auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm. (8 pikë)

(b) AutoMoto dizajnon dhe prodhon automjete luksoze motorike. Kompania punëson 2,500 persona dhe vazhdimisht gjeneron një fitim neto midis 10% dhe 15% të shitjeve. AutoMoto nuk është e listuar në bursë; aksionet e saj mbahen nga 15 individë, shumica e tyre nga e njëjta familje. Aksionari më i madh zotëron 15% të kapitalit aksionar.

Drejtorët ekzekutivë janë kryesisht nga aksionarët. Nuk ka drejtorë joekzekutivë sepse legjislacioni i vendit në të cilin operon AutoMoto nuk kërkon ndonjë gjë të tillë. Drejtorët ekzekutivë janë shumë të suksesshëm në menaxhimin e AutoMoto, pjesërisht nga trajnimi i tyre në teknikat e prodhimit dhe menaxhimit, dhe pjesërisht nga qasja e tyre 'praktike' duke siguruar motivim për punonjësit.

Bordi po shqyrton një zgjerim të rëndësishëm të kompanisë. Sidoqoftë, bankierët e kompanisë janë të shqetësuar me standardin e raportimit financiar pasi drejtori financiar (DF) së fundmi është larguar nga AutoMoto. Bordi është duke e vonuar ofrimin e informacionit shtesë financiar derisa të caktohet një DF i ri.

AutoMoto ka një departament të auditimit të brendshëm, megjithëse auditori kryesor i brendshëm shpesh e komenton se bordi i AutoMoto nuk i kupton raportet e tij ose nuk siguron mbështetje të mjaftueshme për departamentin e tij ose për sistemet e kontrollit të brendshëm brenda AutoMoto. Bordi i AutoMoto pajtohet me këtë pikëpamje. Anders & Co, auditorët e jashtëm të kompanisë, gjithashtu kanë shprehur shqetësim në këtë fushë dhe faktin që departamenti i auditimit të brendshëm përqëndron punën mbi sistemet e kontrollit dhe jo raportimin financiar. Anders & Co emërohen nga bordi i AutoMoto dhe i raportojnë bordit. Bordi i AutoMoto po shqyrton propozimin nga auditori kryesor i brendshëm për të themeluar një komitet të auditimit.

Komiteti do të përbëhej nga një drejtor ekzekutiv, auditori kryesor i brendshëm si dhe tre të emëruar të rinj.

Njëri nga të emëruarit do të ishte drejtor jo-ekzekutiv në bordin e drejtorëve.

#### **Kërkohet:**

Diskutoni mbi përfitimet e AutoMoto nga themelimi i një komiteti të auditimit. (12 pikë)

[Total: 20 pikë]

## **Zgjidhja**

(a) Roli i auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm - ndryshimet

### **Objektivat**

Objektivi kryesor i auditimit të brendshëm është të përmirësojë operacionet e një kompanie, kryesisht në drejtim të validimit të efikasitetit dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të një kompanie.

Objektivi kryesor i auditorit të jashtëm është të shprehë një opinion mbi paraqitje e drejt dhe të sinqert të pasqyrave financiare dhe kërkesat e tjera specifike të juridiksionit siç janë konfirmimi se pasqyrat financiare janë në përputhje me kërkesat e raportimit të përfshira në legjislacion.

### **Raportimi**

Raportet e auditimit të brendshëm zakonisht i drejtohen bordit të drejtorëve, ose personave të tjerë të ngarkuar me qeverisjen siç është komiteti i auditimit. Këto raporte nuk janë në dispozicion të publikut, duke qenë konfidenciale midis auditorit të brendshëm dhe marrësit.

Raportet e auditimit të jashtëm u ofrohen aksionarëve të një kompanie. Raporti i bashkangjitet pasqyrave financiare vjetore të kompanisë dhe për këtë arsye është në dispozicion të publikut për aksionarët dhe çdo lexues të pasqyrave financiare.

### **Fushëveprimi**

Puna e auditorit të brendshëm zakonisht lidhet me operacionet e organizatës, përfshirë sistemet e përpunimit të transaksioneve dhe sistemet për të prodhuar pasqyrat vjetore financiare.

Auditori i brendshëm gjithashtu mund të sigurojë raporte të tjera për menaxhmentin, siç janë auditimet e vlerës për para me të cilat auditorët e jashtëm rrallë përfshihen.

Puna e auditorit të jashtëm lidhet vetëm me pasqyrat financiare të organizatës. Sidoqoftë, sistemet e kontrollit të brendshëm të organizatës do të testohen pasi këto ofrojnë dëshmi mbi plotësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare.

### **Marrëdhënia me kompaninë**

Në shumicën e organizatave, auditori i brendshëm është një punonjës i organizatës, i cili mund të ketë një ndikim në pavarësinë e auditorit. Sidoqoftë, në disa organizata, funksioni i auditimit të brendshëm është i kontraktuar nga jashtë.

Auditori i jashtëm emërohet nga aksionarët e një organizate, duke siguruar një farë shkalle pavarësie nga kompania dhe menaxhmenti.

(b) Përfitimet e komitetit të auditimit në kompani.

### **Ndihma me raportimin financiar (pa ekspertizë financiare)**

Drejtorët ekzekutivë të kompanisë nuk duket se kanë ndonjë aftësi specifike financiare - pasi drejtori financiar është larguar kohët e fundit nga kompania dhe nuk është zëvendësuar ende. Kjo mund të nënkuptojë që raportimi financiar në kompani është i kufizuar ose që drejtorët e tjerë jo-financiarë kalojnë një sasi të konsiderueshme të kohës duke u azhurnuar për çështjet e raportimit financiar.

Një komitet i auditimit do të ndihmojë kompaninë duke siguruar njohuri të specializuara të raportimit financiar mbi një bazë të përkohshme - të paktën një nga të emëruarit e rinj duhet të ketë përvojë relevante dhe të raportimit financiar nën kodet e qeverisjes së korporatave. Kjo do të lejojë që drejtorët ekzekutivë të përqendrohen në drejtimin e kompanisë.

### **Përmirëson sistemet e kontrollit të brendshëm**

Bordi i kompanisë nuk e kupton domosdoshmërisht punën e auditorit të brendshëm, ose nevojën për sisteme të kontrollit. Kjo do të thotë që kontrolli i brendshëm brenda kompanisë mund të jetë i papërshtatshëm ose që punonjësit të mos njohin rëndësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm brenda një organizate.

Komiteti i auditimit mund të rrisë ndërgjegjësimin për nevojën për sisteme të mira të kontrollit të brendshëm thjesht duke qenë i pranishëm në kompani dhe duke edukuar bordin për nevojën për kontrolle të shëndosha. Përmirësimi i 'klimës' së kontrollit të brendshëm do të sigurojë që nevoja për kontrolle të brendshme kuptohet dhe zvogëlon gabimet e kontrollit.

### **Mbështetja te auditorët e jashtëm**



Auditorët e brendshëm të kompanisë aktualisht raportojnë në bord. Siç është vërejtur më parë, mungesa e ekspertizës financiare dhe të kontrollit në bord do të thotë që raportet dhe këshillat e auditorit të jashtëm nuk do të kuptohen domosdoshmërisht - dhe bordi mund të mbështetet shumë te auditorët

Nëse kompania raporton tek një komitet auditimi kjo do të zvogëlojë varësinë e bordit nga auditorët e jashtëm. Komiteti i auditimit mund të ketë kohë për të kuptuar komentet e auditorit të jashtëm, dhe pastaj përmes drejtorit jo-ekzekutiv, të sigurojë që bordi të marrë masa për ato komente.

#### **Emërimi i auditorëve të jashtëm**

Aktualisht, bordi i kompanisë emëron auditorët e jashtëm. Kjo ngre çështje të pavarësisë pasi bordi mund të familjarizohet shumë me auditorët e jashtëm dhe kështu të emërojë bazuar në miqësi sesa në merita.

Nëse është krijuar një komitet i auditimit, atëherë ky komitet mund të rekomandojë emërimin e auditorëve të jashtëm. Komiteti do të ketë kohën dhe ekspertizën për të rishikuar cilësinë e shërbimit të ofruar nga auditorët e jashtëm, duke hequr çështjen e pavarësisë.

#### **Kërkesat e qeverisjes së korporatave - praktika më e mirë**

Kompania nuk ka nevojë të ndjekë kërkesat e qeverisjes së korporatave (kompania nuk është e listuar). Sidoqoftë, mosrespektimi i këtyre kërkesave mund të fillojë të ketë efekte anësore. Për shembull, banka e kompanisë tashmë është e shqetësuar për mungesën e transparencës në raportim.

Krijimi i një komiteti të auditimit do të tregojë që bordi i kompanisë është i përkushtuar për mirëmbajtjen e sistemeve të përshtatshme të brendshme në kompani dhe sigurimin e standardit të raportimit që pritet nga kompanitë e mëdha. Marrja e kredisë së re bankare duhet të jetë gjithashtu më e lehtë pasi banka do të jetë e kënaqur me standardet e raportimit financiar.

#### **Duke mos pasur asnjë drejtor joekzekutiv - këshilla të pavarura për bordin**

Aktualisht kompania nuk ka ndonjë drejtor jo-ekzekutiv. Kjo do të thotë që vendimet e drejtorëve ekzekutivë nuk po sfidohen nga drejtorë të tjerë të pavarur nga kompania dhe me pak ose aspak interes financiar në kompani.

Emërimi i një komiteti të auditimit me një drejtor jo-ekzekutiv në bordin e kompanisë do të fillojë të ofrojë disa të dhëna nga anëtarët jo-ekzekutiv në takimet e bordit. Megjithëse nuk është i mjaftueshëm për sa i përket kërkesave të qeverisjes së korporatave (pritet të ketë numër të barabartë të drejtorëve ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë), kjo tregon se bordi i kompanisë po përpiqet të krijojë sisteme të përshtatshme të qeverisjes.

#### **Këshilla për menaxhimin e rrezikut**

Së fundmi, ka fusha të tjera të përgjithshme ku kompania do të përfitonte nga një komitet auditimi. Për shembull, mungesa e strukturave të qeverisjes së korporatave ndoshta do të thotë se kompania nuk ka një komitet të menaxhimit të rreziqeve. Komiteti i auditimit gjithashtu mund të ofrojë këshilla për menaxhimin e rrezikut, duke ndihmuar në uljen e ekspozimit ndaj rrezikut të ndërmarrjes.

## Detyra 5

(a) Listoni dhe shpjegoni KATËR faktorë që do të ndikojnë në gjykimin e auditorit në lidhje me mjaftueshmërinë e dëshmive të përfuara të auditimit. **(4 pikë)**

(b) SNA 580 Përfaqësimet e Menaxhimit ofron udhëzime për përdorimin e përfaqësimeve të menaxhmentit si dëshmi të auditimit.

**Kërkohet:**

Listoni gjashtë elemente që mund të përfshihen në një letër përfaqësimi të menaxhmentit. **(3 pikë)**

(c) Pas kryerjes së testeve të kontrolleve, auditori është i mendimit se dëshmitë e auditimit nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur opinionin e auditimit; me fjalë të tjera u gjetën shumë gabime në kontrolle të brendshme.

**Kërkohet:**

Shpjegoni TRE veprime që auditori tani mund të marrë si përgjigje ndaj këtij problemi. **(3 pikë)**

**[Total: 10 pikë]**

## Zgjidhja

### (a) Mjaftueshmëria e dëshmime

- Vlerësimi i rrezikut në nivelin e pasqyrës financiare dhe / ose nivelin individual të transaksionit. Ndërsa rreziku rritet, atëherë më shumë kërkohen dëshmi.
- Materialiteti i një zëri. Më shumë dëshmi normalisht do të mblidhen për zërat material, ndërsa zërat jomateriale mund thjesht të rishikohen për t'u siguruar që ato duken të sakta.
- Natyra e sistemeve të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm. Auditori do të mbështetet më shumë në sistemet e mira të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm duke kufizuar sasinë e dëshmime të kërkuara auditimit.
- Njohuritë dhe përvoja e auditorit për biznesin. Kur auditori ka njohuri të mira të së kaluarës për biznesin dhe i beson integritetit të stafit, atëherë do të kërkohen më pak dëshmi.
- Gjetjet nga procedurat e auditimit. Aty ku gjetjet nga procedurat përkatëse të auditimit janë të kënaqshme (p.sh. testet e kontrolleve mbi të arkëtueshmet), atëherë do të mblidhen dëshmi thelbësore.
- Burimi dhe besueshmëria e informacionit. Kur dëshmitë merren nga burime të besueshme (p.sh. dëshmit të shkruara), atëherë kërkohen më pak dëshmi sesa nëse burimi nuk ishte i besueshëm (p.sh. dëshmitë verbale).

### (b) Përmbajtja e letrës së përfaqësimit të menaxhmentit

- Asnjë parregullsi që përfshin menaxhmentin ose punonjësit që mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjithë librat dhe dokumentacioni mbështetës janë vënë në dispozicion të auditorëve
- Informacioni dhe shpalosjet në lidhje me palët e lidhura është i plotë
- Pasqyrat financiare janë të pastra nga anomalitë materiale, përfshirë edhe mungesat
- Asnjë mosrespektim i ndonjë ligji ose autoriteti rregullator
- Asnjë plan që do të ndryshojë materialisht vlerën kontabël ose klasifikimin e pasurive ose detyrimeve në pasqyrat financiare
- Nuk ka plane për të braktisur ndonjë linjë produkti që do të rezultojë me stoqe të tepërta ose të vjetëruar
- Asnjë ngjarje, përveç nëse është shpalosur tashmë, pas përfundimit të periudhës raportuese që ka nevojë për shpalosje në pasqyrat financiare.

### (c) Procedurat shtesë të auditimit

- Auditori mund të zgjerojë sasinë e testeve të kontrolleve në atë fushë të auditimit. Kjo mund të tregojë se dobësia e kontrollit nuk ishte aq e keqe sa mendohej fillimisht.
- Problemi mund të ngrihet tek drejtorët, ose verbalisht ose në një letër menaxhmenti, për t'u siguruar që ata janë të vetëdijshëm për problemin.
- Auditori mund të kryejë procedura shtesë thelbësore në fushën e auditimit. Ky veprim do të ndihmojë për të përcaktuar sasinë e gabimit dhe bën supozimin e nënkuptuar se sistemi i kontrollit nuk po funksionon si duhet.
- Nëse çështja nuk zgjidhet, atëherë auditori gjithashtu do të duhet të marrë parasysh një kualifikim në raportin e auditimit; formulimi i saktë në varësi të materialitetit të gabimeve të gjetura.